



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 61

2001

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.692, datë 13.12.2001	Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë.....	1907
Marrëveshja e ligjit nr.8838, datë 22.11.2001	Traktati i OBPI-së i të drejtave të autorit me deklaratën e miratuar të Konferencës Diplomatike që adaptoi Traktatin dhe Dispozitat e Konventës së Bernës (1971), të cilave u referohet Traktati.....	1909

V E N D I M
Nr. 692, datë 13.12.2001

PËR MASAT E VEÇANTA TË SIGURIMIT DHE MBROJTJES SË SHËNDETIT NË PUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 40 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punëmarrësve të bëhet nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme për parandalimin e rreziqeve në punë.

2. Punëdhënësi, për të mbrojtur dhe siguruar jetën dhe shëndetin e punëmarrësit në punë është i detyruar:

- a) të shmangë rreziqet, duke vlerësuar ato realisht dhe në origjinë;
- b) të vendosë punëmarrësit në punë sipas:
 - aftësive profesionale;
 - gjendjes shëndetësore të bazuar në vizitën mjekësore, të kryer nga specialistë, para pranimit në punë;
 - moshës;
 - seksit.
- c) të marrë parasysh zhvillimin e teknikës;
- ç) të zbatojë masat që vënë mbrojtjen kolektive mbi ato individuale;
- d) t'u japë punëmarrësve instruksionet e duhura për mbrojtjen e shëndetit në punë dhe për njohjen dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- dh) të vendosë në përdorimin e makinerive dhe të mekanizmave me shkallë rrezikshmërie kolektive punëmarrës të pajisur me dëshmi aftësie;
- e) të marrë në provë çdo muaj punëmarrësit e pakualifikuar dhe çdo 3 muaj punëmarrësit e kualifikuar për përvetësimin e rregulloreve të sigurimit teknik.

3. Punëdhënësi duhet të vlerësojë (të ketë parasysh) aftësitë profesionale të punëmarrësve në fushën e sigurimit dhe të shëndetit kur u ngarkon detyrat, si dhe të garantojë se vetëm punëmarrësit që kanë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme mund të futen në zonat me rrezik të madh dhe të veçantë. Kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e sigurimit teknik.

4. Punëdhënësi duhet t'i pajisë punëmarrësit me mjete mbrojtëse, individuale të përshtatshme për realizimin e funksioneve që kanë dhe të kujdeset për përdorimin e duhur të tyre, sipas natyrës së punës. Gjithashtu, punëdhënësi duhet të kujdeset që pajisjet e punës të jenë të përshtatshme dhe të garantojnë sigurimin e shëndetit të punëmarrësve gjatë përdorimit.

5. Punëdhënësi duhet të garantojë që çdo punëmarrës të aftësohet dhe të formohet profesionalisht në fushën parandaluese që në fillim të punës e në vazhdim, duke pasur parasysh ndryshimet e funksionit që ai kryen ose në rastet kur futen teknologji të reja apo bëhen ndryshime në pajisjet e punës. Formimi duhet të përqendrohet, veçanërisht, në vendin e punës dhe në funksion të çdo punëmarrësi.

6. Një herë në çdo muaj punëdhënësi duhet të instruktojë punëmarrësit për makineritë dhe teknologjitë e reja. Çdo punëmarrës duhet të ketë njohuri për të respektuar rregullat, duke mos rrezikuar veten dhe çdo person që ka pranë nga veprimi i lëndëve helmuese, rryma elektrike, zjarri ose nga goditjet mekanike.

7. Punëdhënësi është i detyruar që:

- të vendosë në vende të dukshme të sektorëve të punës dhe të lexueshme nga punëmarrësit rregullat e sigurimit teknik për dhënien e ndihmës së parë dhe rregullat për mbrojtjen në punë;
- të bëjë matje në mjediset e brendshme të punës për nivelet e ndotjes nga lëndët kimike, pluhuri, lagështia, zhurmat dhe t'i krahasojë rezultatet me normat e lejueshme.

8. Kur punëmarrësit janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj një rreziku të rëndë, punëdhënësi është i detyruar t'i njoftojë menjëherë punëmarrësit e cenuar për praninë e këtij rreziku dhe të marrë masat e duhura për parandalimin e tij.

9. Punëdhënësi duhet t'u garantojë punëmarrësve kontroll periodik mjekësor për gjendjen e tyre shëndetësore, në funksion të rreziqeve që lidhen me punën, me shpenzimet e tij. Masat e kujdesit dhe të kontrollit të shëndetit të punëmarrësve të zbatohen duke respektuar, gjithmonë, të drejtën e intimitetit dhe të dinjitetit personal të punëmarrësit dhe karakterit konfidencial të çdo të dhëne që ka lidhje me gjendjen e tij shëndetësore.

10. Rregullat e kontrollit shëndetësor të pranimit në punë dhe periodik të punëmarrësve përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë. Për kontrollin paraprak periodik të punëmarrësve punëdhënësit bëjnë kontratë me strukturat shëndetësore.

11. Punëdhënësit janë të detyruar të mbrojnë gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji ndaj agjentëve të dëmshëm, në përputhje me kërkesat e raportit mjekësor, të lëshuar nga mjeku specialist. Kur paraqitet rrezik për sigurimin dhe shëndetin apo ndonjë ndikim të mundshëm mbi shtatzëninë apo mbi qumështin e gjirit të këtyre punëmarrësve, punëdhënësi duhet të marrë masat e nevojshme për të shmangur ekspozimin e këtij rreziku, për të përmirësuar kushtet e punës dhe për ndërrimin në një vend tjetër pune që ka më pak rrezikshmëri nga lëndët kimike për shëndetin e nënës dhe të fëmijës.

12. Çdo punëmarrës ka detyrë të kujdeset për sigurimin dhe shëndetin në punë. Punëmarrësit, në përputhje me formimin dhe me instruksionet e punëdhënësit, duhet në mënyrë të veçantë;

- të përdorin, në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me natyrën dhe rreziqet e parashikuara, makinat, aparatet, substancat e rrezikshme pajisjet e transportit dhe, në përgjithësi, të gjitha mjetet e tjera, me të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre;

- të përdorin në mënyrë të vazhdueshme mjetet dhe pajisjet mbrojtëse të dhëna nga punëmarrësi.

13. Kur inspektori i punës verifikon moszbatimin e normativave për parandalimin e rreziqeve në punë dhe gjykon se kjo veprimtari mund të sjellë pasoja të rënda urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të punës.

Kjo masë i komunikohet punëdhënësit, i cili menjëherë vë në dijeni punëmarrësit.

Rifillimi i punës pas ndërprerjes bëhet nga inspektori i punës, kur shmangen shkaqet që e sollën këtë ndërprerje. Gjatë ndërprerjes së punës punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë punëmarrësit në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

TRAKTATI

I OBPI-SË I TË DREJTAVE TË AUTORIT ME DEKLARATËN E MIRATUAR TË KONFERENCËS DIPLOMATIKE QË ADAPTOI TRAKTATIN DHE DISPOZITAT E KONVENTËS SË BERNËS (1971), TË CILAVE U REFEROHET TRAKTATI

OBPI
Gjenevë 1997

PARATHËNIA

Palët Kontraktuese,

Duke dëshiruar të zhvillojnë dhe të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të autorëve në punën e tyre letrare dhe artistike në një mënyrë sa më efektive dhe të barabartë që të jetë e mundur,

Duke njohur nevojën të prezantojnë rregulla të reja ndërkombëtare dhe të qartësojnë interpretimin e rregullave ekzistuese, në mënyrë që të mundësojnë zgjidhje të përshtatshme ndaj çështjeve të ngritura nga zhvillimet ekonomike, sociale, kulturore dhe teknologjike,

Duke njohur përpjekjet e thella të zhvillimit dhe konvergencën e teknikave të informimit dhe të komunikimit mbi prodhimin dhe shfytëzimin e veprave artistike apo letrare,

Duke theksuar rëndësinë e jashtëzakonshme të ruajtjes së të drejtës së autorit si një inkurajim për krijimtarinë artistike dhe letrare,

Duke njohur nevojën për të ruajtur një ekuilibër midis të drejtave të autorit me interesat e përgjithshme publike, veçanërisht në fushën e arsimit e të kërkimit shkencor dhe të hyrjes në informacion siç është pasqyruar në Konventën e Bernës,

Bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Marrëdhënia me Konventën e Bernës

(1) Ky traktat është një marrëveshje e veçantë brenda kuptimit të nenit 20 të Konventës së Bernës për mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare për Palët Kontraktuese që janë vende të Bashkimit Europian. Siç është vendosur në atë Konventë, ky Traktat nuk do të ketë asnjë lidhje me traktate të tjera, përveçse me Konventën e Bernës, gjithashtu nuk do të paragjykojë asnjë të drejtë apo detyrim të vendosur në traktate të tjera.

(2) Asgjë në këtë Traktat nuk do të devijojë nga detyrimet ekzistuese që Palët Kontraktuese kanë ndaj njëri-tjetrit në Konventën e Bernës, lidhur me mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare.

(3) Që këtë e tutje, "Konventa e Bernës" do t'i referohet Aktit të Parisit të 24 korrikut 1971, të kësaj Konvente, për mbrojtjen e punëve artistike dhe letrare.

(4) Palët Kontraktuese do të bien dakord me nenet 1-21 dhe shtojcën e Konventës së Bernës.¹

Neni 2

Mundësia e mbrojtjes së të drejtave të autorit

E drejta e autorit shtrihet në të shprehur dhe jo në ide, procedura, metoda veprimi ose koncepte matematikore.

Neni 3

Zbatimi i neneve 2-6 të Konventës së Bernës

Palët Kontraktore mund të zbatojnë mutatis mutandis dispozitat e neneve 2-6 të Konventës së Bernës në funksion të mbrojtjes së parashikuar për to në këtë Traktat. 2

Neni 4

Programet kompjuterike

Programet kompjuterike mbrohen si punë letrare brenda kuptimit të nenit 2 të Konventës së Bernës. Të tilla mbrojtje zbatohen në programet kompjuterike, sidoqoftë mënyra ose forma e shprehjes së tyre.³

1) Një deklaratë e pranuar që ka të bëjë me nenin 1(4): E drejta e riprodhimit, siç është përcaktuar në nenin 9 të Konventës së Bernës, në veçanti të përdorimi i veprave në forma dixhitale. Kuptohet që depozitimi i një veprë të ruajtur në një formë dixhitale në një mjedis elektronik përbën një prodhim në përmbushje me përmbajtjen e nenit 9 të Konventës së Bernës.

²) Deklaratë e miratuar që ka të bëjë me nenin 3: Kuptohet që në aplikimin e nenit 3 të këtij Traktati, shprehja "vend i Bashkimit" në nenin 2-6 e Konventës së Bernës do të lexohet sikur t'i referohej një Pale Kontraktuese të këtij Traktati, në aplikimin e këtyre neneve të Bernës në funksion të mbrojtjes së parashikuar në këtë Traktat. Gjithashtu, kuptohet që vend jashtë Bashkimit në këto nene të Konventës në të njëjtat kushte do të lexohet për Konventën e Bernës të këtij Traktati. Së fundmi, kuptohet se një referencë në nenin 3-6 të Konventës për një "kombëtare të një vendi të njërit prej vendeve të Bashkimit" kur këto nene janë të aplikuara në Traktat do të kuptohen në lidhje me një organizëm ndërqeveritar që është një Palë Kontraktuese në këtë Traktat, shtetas i njërit prej vendeve që është anëtar i kësaj organizme.

³) Deklaratë e miratuar që ka të bëjë me nenin 4: Mundësia e mbrojtjes të programeve kompjuterike nën nenin 4 të këtij Traktati përputhet me nenin 2 dhe është konsistent me Nenin 2 të Konventës së Bernës dhe baraz me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes TRIPS.

Neni 5
Përpilimi i të dhënave (regjistrat)

Organizimi i të dhënave ose materialeve të tjera, në çdo formë, që si rezultat i seleksionimit ose organizimit të përmbajtjes konsiston në krijimtarinë intelektuale, mbrohen. Kjo mbrojtje nuk ka lidhje me të dhënat ose materialin në vetvete dhe nuk paragjykon asnjë të drejtë autorësie që ekziston në të dhënat ose materialet e përpilimit. 4

Neni 6

(1) Autorët e veprave letrare dhe artistike gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar vënien në dispozicion të publikut të punëve të tyre origjinale ose të kopjeve nëpërmjet shitjes ose transferimit të pronësisë në një mënyrë tjetër.

(2) Asgjë në këtë Traktat nuk do të ndikojë në lirinë e Palëve Kontraktore për të përcaktuar kushtet, nëse ka, nën të cilat përdorimi i të drejtave në paragrafin (1) zbatohet pas shitjes së parë ose transferimit të pasurisë në një formë tjetër të origjinalit ose kopjes së veprës, me autorizimin e autorit. 5

Neni 7
E drejta e qirasë

(1) Autorët e:

(i) programeve kompjuterike;

(ii) punëve kinematografike; dhe

(iii) punëve të trupëzuara në fonogram, siç përcaktohet në ligjin kombëtar të Palëve Kontraktuese, gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar qiramarrjen tregtare në publik të origjinalit ose kopjes së veprave të tyre.

(2) Paragrafi (1) nuk zbatohet:

(i) në rastin e programeve kompjuterike, kur programi nuk është vetë objekti kryesor i qiramarrjes; dhe

(ii) në rastin e punëve kinematografike, në rast kur kjo qiramarrje tregtare ka shkaktuar përhapje të kopjeve të këtyre veprave, duke dëmtuar materialisht të drejtën ekskluzive të riprodhimit.

(3) Pa kundërshtuar dispozitat e paragrafit (1), Palët Kontraktuese, që në 15 prill 1994 vazhdojnë të kenë në fuqi një sistem të arsyeshëm shpërblimi të autorëve për marrjen me qira të kopjeve të punëve të tyre të shprehura në fonogram, mund ta mbajnë atë sistem në qoftë se qiramarrja e punëve të shprehura në fonogram nuk rrit dëmtimin material të së drejtës ekskluzive të riprodhimit të autorëve.^{6 7}

⁴) Deklaratë e miratuar që ka të bëjë me nenin 5: Mundësia e mbrojtjes për përpilimin e të dhënave (regjistrave) në bazë të nenit 5 të këtij Traktati në përputhje me nenin 2 të Konventës së Bernës dhe është baraz me dispozitat përgjegjëse të Marrëveshjes së TRIPS.

⁵) Deklaratë e miratuar që ka të bëjë me nenin 6-7: Siç përdoret në këto nene, shprehja "kopje" dhe "origjinale dhe kopje" duke qenë subjekt i të drejtës së shpërndarjes dhe të drejtës për qira në bazë të asaj që thuhet në nenet, i referohet vetëm kopjeve të përcaktuara që mund të vihen në qarkullim si objekte të prekshme.

⁶) Deklarata e miratuar që ka të bëjë me nenet 6,7 siç përdoren në këto nene, shprehjet "kopje" dhe "origjinal dhe kopje") duke qenë subjekt i të drejtës së shpërndarjes dhe të drejtës së qirasë në bazë të neneve, i referohen veçanërisht kopjeve të përcaktuara që duhet të dalin në qarkullim si objekte të prekshme.

⁷) Deklaratë e miratuar që ka të bëjë me nenin 7: Kuptohet që dispozitat për lehtësinë e mundësisimit të bërjes së një komunikimi nuk ka të bëjë me komunikimin brenda kuptimit të Traktatit të Konventës së Bernës. Kuptohet që asgjë në nenin 8 nuk pengon një palë kontraktuese të zbatojë nenin 11 të dytë.

Neni 8

E drejta e komunikimit me publikun

Pa paragjykuar dispozitat e nenit 11(1)(ii), 11 i dyti(1)(i) dhe (ii), 11 i treti(1)(i), 14(1) (ii) dhe 14 dyti(1) të Konventës së Bernës, autorët e veprave artistike dhe letrare gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar çdo komunikim të veprave të tyre me publikun, me ose pa kabëll, duke përfshirë vënien në dispozicion të publikut të veprave të tyre, në atë mënyrë që anëtarët e publikut të kenë të mundur hyrjen në to nga vendi dhe koha e zgjedhur personalisht nga ta. 8

Neni 9

Kohëzgjatja e mbrojtjes së veprave fotografike

Në lidhje me veprat fotografike, Palët Kontraktuese nuk do të zbatojnë dispozitat e nenit 7(4) të Konventës së Bernës.

Neni 10

Kufizimet dhe përjashtimet

(1) Palët Kontraktore mund të parashikojnë në legjislacionin e tyre kombëtar kufizime dhe përjashtime të të drejtave të autorëve për veprat artistike apo letrare të garantuara nga ky Traktat në disa raste të veçanta, por që nuk do të konfliktohen me shfrytëzimin normal të veprës dhe nuk do të paragjykojnë në mënyrë të paarsyeshme interesat e ligjshme të autorëve.

(2) Palët Kontraktore, kur zbatojnë Konventën e Bernës mund të përcaktojnë ndonjë kufizim ose përjashtim të të drejtave të parashikuara për ta në disa raste të veçanta që nuk konfliktohen me shfrytëzimin normal të punës dhe nuk paragjykojnë pa arsye interesat legjitime të autorit. 9

Neni 11

Detyrimet që i përkasin masave teknologjike

Palët Kontraktore do të parashikojnë mbrojtje të përshtatshme ligjore dhe sanksione ligjore efektive kundër shmangies nga masat teknologjike efektive, që janë përdorur nga autorët në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tyre të njohura nga ky Traktat ose Konventa e Bernës dhe që kufizojnë veprime lidhur me punët e tyre, të cilat nuk janë të autorizuar nga autorët e lidhur apo të lejuar nga ligji.

Neni 12

Detyrimet që përmban informacioni i të drejtave të menaxhimit

(1) Palët Kontraktore duhet të sigurojnë sanksione ligjore efektive dhe të përshtatshme kundër çdo personi që, me dijeni, kryen cilëndo nga sjelljet e mëposhtme ose lidhur me sanksionet civile kur ka baza të arsyeshme të dijë që do të influencojë, mundësojë, lehtësojë ose do të fshehtë një shkelje të çdo të drejte të mbuluar nga ky Traktat ose Konventa e Bernës:

(i) të zhvendosë ose të ndryshojë çdo informacion elektronik të së drejtës së menaxhimit pa autorizim;

(ii) të shpërndajë, importojë për shpërndarje, radiopërhapë ose komunikojë me publikun, pa patur autorizim, veprat ose kopje të veprave, duke ditur që informacioni elektronik i menaxhimit të të drejtave është zhvendosur ose ndryshuar pa autoritet.

⁸) Deklaratë e miratuar që ka të bëjë me nenin 8: Kuptohet që dispozitat për lehtësinë e mundësimin të bërjes së një komunikimi nuk ka të bëjë me komunikimin brenda kuptimit të Konventës së Bernës. Kuptohet që asgjë në nenin 8 nuk pengon një palë kontraktuese të zbatojë nenin 11 të dytë.

⁹) Kuptohet që dispozitat e nenit 10 lejojnë Palët Kontraktuese të çojnë përpara dhe të shtrijnë përkatësisht në mjedisin dixhital kufizime dhe përjashtime në ligjet e tyre kombëtare që janë konsideruar të pranueshme nën Konventën e Bernës. Kështu këto dispozita duhet të kuptohen që të lejojnë Palët Kontraktuese të planifikojnë përjashtime dhe kufizime të reja që janë përjashtime në mjedisin e rrjetit dixhital.

(2) Siç është përdorur në këtë nen, "informacioni i së drejtës së menaxhimit" kupton informacionin që identifikon veprën, autorin e veprës, pronarin e ndonjë të drejte në veprë ose informacion rreth termave dhe kushteve të përdorimit të veprës, ose të ndonjë numri ose kodi që mban informacion të tillë, kur njëra nga këto pika të informacionit i bashkëngjitet kopjes së një vepre ose paraqitet në lidhje me komunikimin e veprës në publik 10.

Neni 13 **Zbatimi në kohë**

Palët Kontraktore do të zbatojnë dispozitat e nenit 18 të Konventës së Bernës për të gjitha mbrojtjet e parashikuara prej këtij Traktati.

Neni 14 **Dispozitat mbi hyrjen në fuqi të të drejtave**

(1) Palët Kontraktore marrin përsipër të adaptojnë, në përputhje me sistemet e tyre ligjore, masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e këtij Traktati.

(2) Palët Kontraktore do të sigurojnë që procedurat e hyrjes në fuqi do të jenë të vlefshme ndën ligjet e tyre, aq sa të lejojnë akte efektive përballë çdo shkeljeje të të drejtave të mbuluara nga ky Traktat, duke përfshirë sanksione për të ndaluar shkeljet dhe sanksione të vlefshme për shkelje të mëtejshme.

Neni 15 **Asambleja**

(1) (a) Palët Kontraktuese duhet të kenë një Asamble.

(b) Çdo Palë Kontraktore do të përfaqësohet nga një delegat që mund të ndihmohet nga delegatë të ndryshëm, këshilltarë dhe ekspertë.

(c) Shpenzimet e secilit delegacion do të mbuloohen nga Palët Kontraktore që ka caktuar delegacionin. Asambleja mund t'i kërkojë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, që këtej e tutje të quajtur OBPI), ndihmë financiare për të lehtësuar pjesëmarrjen e delegacioneve të Palëve Kontraktuese si vende në zhvillim, konform me praktikën e krijuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ose që janë vende në tranzicion drejt ekonomisë së tregut.

(2) (a) Asambleja do të angazhohet me çështje lidhur me mbajtjen dhe zhvillimin e këtij Traktati dhe të zbatimit dhe veprimit të këtij Traktati.

(b) Asambleja do të kryejë funksionin e dhënë asaj nga neni 17 (2) në lidhje me aplikimin e disa organizatave ndërkombëtare për t'u bërë Palë në këtë Traktat.

(c) Asambleja do të vendosë mbledhjen e çdo Konferencë Diplomatike për rishikimin e këtij Traktati dhe i jep instruksionet e duhura Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së për përgatitjen e Konferencave Diplomatike të tilla.

(3) (a) Çdo Palë Kontraktore që është një Shtet do të ketë vetëm një votë dhe do të votojë vetëm në emrin e tij.

(b) Çdo Palë Kontraktore që është një organizatë ndërqeveritare do të marrë pjesë në votim në vend të Shteteve të veta anëtare me një numër votash të barabarta me numrin e Shteteve të veta anëtare që janë Palë në këtë Traktat. Asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim nëse një nga Shtetet e saj anëtare do të ushtrojë të drejtat e saj për të votuar dhe anasjelltas.

(4) Asambleja do të mbledhet në sesione të zakonshme një herë në dy vjet, nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së.

¹⁰) Deklaratë e miratuar që ka të bëjë me nenin 10: Kuptohet që termi "shkelje e çdo të drejte mbuluar nga traktati" përfshin të dyja të drejtat ekskluzive dhe të drejtën e shpërblimit. Më tej kuptohet që Palët Kontraktuese nuk do të bazohen tek ky nen për të planifikuar ose zbatuar sistemet menaxhuese të të drejtave që do të kishin influencë në imponimin e formaliteteve të cilat nuk janë të lejuara në këtë traktat ose në Konventën e Bernës, duke ndaluar lëvizjen e lirë të të mirave ose duke penguar gëzimin e të drejtave nga ky traktat.

(5) Asambleja do të krijojë rregullat e veta procedurale, duke përfshirë drejtimin e mbledhjeve të sesioneve të jashtëzakonshme, kërkesën për kuorum dhe subjektet e dispozitave të këtij Traktati, shumicën e kërkuar për vendime të ndryshme.

Neni 16
Byroja Ndërkombëtare

Byroja Ndërkombëtare e OBPI-së do të kryejë detyrat administrative lidhur me Traktatin.

Neni 17
E drejta e zgjedhjes për t'u bërë Palë në Traktat

(1) Çdo Shtet anëtar i OBPI-së mund të bëhet Palë në Traktat.

(2) Asambleja mund të vendosë të pranojë si Palë në këtë Traktat çdo organizatë ndërqeveritare që deklaron se është kompetente në lidhje me të gjitha Shtetet anëtare dhe legjislacionin e tyre në çështjet e mbuluara nga ky Traktat dhe është e autorizuar me korrektesë, në përputhje me procedurat e veta të brendshme, për t'u bërë Palë në Traktat.

(3) Komuniteti European, duke bërë deklaratën sipas referimeve në paragrafin e mësipërm në Konferencën Diplomatike që adaptoi këtë Traktat, mund të bëhet Palë në këtë Traktat.

Neni 18
Të drejtat dhe detyrimet nën këtë Traktat

Kushtëzuar nga ndonjë dispozitë e veçantë në kundërshtim me këtë Traktat, çdo Palë Kontraktore gëzon të gjitha të drejtat dhe merr përsipër të gjitha detyrimet nën këtë Traktat.

Neni 19
Nënshkrimi i Traktatit

Ky Traktat është i hapur për nënshkrim deri në 31 dhjetor 1997 nga çdo Shtet anëtar i OBPI-së dhe nga Komuniteti European.

Neni 20
Hyrja në fuqi e Traktatit

Ky Traktat hyn në fuqi 3 muaj pas depozitimit të 30 instrumenteve të ratifikimit ose pranimit nga Shtetet, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së.

Neni 21
Data efektive e bërjes palë në Traktat

Ky Traktat lidh:

(i) 30 Shtetet që i referohen nenit 20, nga data në të cilën ky Traktat ka hyrë në fuqi;

(ii) çdo Shtet tjetër, me kalimin e tre muajve nga data në të cilën Shteti ka depozituar instrumentin e tij pranë Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së;

(iii) Komuniteti European, me kalimin e tre muajve nga depozitimi të instrumentit të ratifikimit ose pranimit, nëse instrumenti është depozituar para hyrjes në fuqi të këtij Traktati sipas nenit 20 ose tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati nëse ky instrument është depozituar para hyrjes në fuqi të këtij Traktati;

(iv) çdo organizatë ndërqeveritare që është pranuar Palë në Traktat, me kalimin e tre muajve pas depozitimit të instrumentit të tij të pranimit.

Neni 22
Mosrezervimet e Traktatit

Asnjë rezervim nuk pranohet në këtë Traktat.

Neni 23
Denoncimi i Traktatit

Ky Traktat mund të denoncohet nga çdo Palë Kontraktore me njoftimin e adresuar Drejtorit të Përgjithshëm të OBPI-së. Çdo denoncim do të ketë efekt një vit nga data që Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftimin.

Neni 24
Gjuhët e Traktatit

(1) Ky Traktat është nënshkruar në një origjinal të vetëm në gjuhët: anglisht, arabisht, kineze, franceze, ruse dhe spanjolle. Versionet në të gjitha këto gjuhë janë autentikisht të njëjta.

(2) Një tekst zyrtar në një gjuhë tjetër të ndryshme nga ato të cilave u referohet paragrafi i parë do të krijohet nga Drejtori i Përgjithshëm i OBPI-së me kërkesën e Palës së interesuar, pas konsultimit me të gjitha Palët e interesuara. Për qëllime të këtij paragrafi me "palë të interesuar" do të kuptojmë me çdo vend anëtar i OBPI – së, gjuha zyrtare e të cilit ose një nga gjuhët zyrtare është përfshirë, si edhe Komuniteti Europian dhe çdo organizatë ndërqeveritare që mund të jetë Palë në këtë Traktat, nëse është përfshirë një nga gjuhët e tij.

Neni 25
Depozitimi

Drejtori i Përgjithshëm i OBPI-së, është depozituesi i këtij Traktati.

Dispozitat e Konventës së Bernës për mbrojtjen e veprave artistike dhe letrare (1971), që i referohet traktatit të OBPI-së të të drejtave të autorit*

Vendet e Bashkimit, duke qenë njësoj të dëshiruar për të mbrojtur në një mënyrë efektive, të drejtë dhe të barabartë të mundur, të drejtat e autorëve në veprat e tyre letrare dhe artistike,

Duke njohur rëndësinë e punës së Konferencës së Revizionit të mbajtur në Stokholm më 1967,

Kanë vendosur të rishikojnë Aktin e adaptuar nga Konferenca e Stokholmit, ndërsa mbajnë pa ndryshuar nenet 1-20 dhe 22-26 të Aktit.

Si përfundim, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, pasi kanë prezantuar fuqitë e tyre të plota të pranuar në formë të saktë dhe të duhur, kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

[Krijimi i Bashkimit]**

Vendet në të cilat aplikohet kjo Konventë ndërtojnë një Bashkim për mbrojtjen e të drejtave të autorit në veprat e tyre letrare dhe artistike.

Neni 2

[Veprat e mbrojtura: 1. "Veprat artistike dhe letrare"; 2. Kërkesat e mundshme të fiksimit;

* Dispozitat që përmenden këtu i referohen neneve 1(4) dhe 1(1), 2,3,8,9 dhe 13 të OBPI- së. Traktati për të drejtën e autorësisë.

** Për çdo nen dhe shtojcë i është dhënë titull për të lehtësuar identifikimin e tyre; në tekstin e firmosur nuk ka tituj.

3. Veprat në vazhdim; 4. Tekstet zyrtare; 5. Mbledhjet; 6. Detyrimi për mbrojtje; Të mirat e mbrojtjes; 7. Veprat e artit të aplikuar dhe dizenjot industriale; 8. Të reja].

(1) Shpehja "vepra letrare dhe artistike" përfshin çdo prodhim në letërsi, shkencë dhe pronësi artistike, sidoqoftë mënyra apo forma e shprehjes së tij, si libra, pamflet dhe shkrime të tjera; leksione, adresa, predikime dhe vepra të tjera të së njëjtës natyrë; vepra dramatike ose muziko-dramatike; koreografi dhe argëtime në një spektakël memec; kompozime muzikore me ose pa fjalë; vepra kinematografike ku janë përvetësuar vepra të shprehura nga një proces analog me kinematografinë; vepra vizatimi, pikturë, arkitekture, skulpturë, gravurë dhe litografie, vepra fotografike ku janë përvetësuar vepra të shprehura nga një proces analog me fotografiminë, vepra të artit të aplikuar; ilustrime, harta, plane, skica, dhe vepra tredimensionale të lidhura me gjeografinë, topografinë, arkitekturën ose shkencën.

(2) Gjithsesi, do të jetë një çështje për legjislacionin e vendeve të Bashkimit për t'u përshkruar nëse ato vepra në përgjithësi ose një kategori specifike veprash nuk do të mbrohen nëse nuk kanë qenë të fiksuara në njëfarë forme materiale.

(3) Përkthimet, përshtatjet, rregullimet e muzikës dhe ndryshimet e tjera të veprave artistike ose letrare do të mbrohen si veprat origjinale pa paragjykuar të drejtën e autorit në veprën origjinale.

(4) Do të jetë një çështje për legjislacionin e vendeve të Unionit që të përcaktojnë mbrojtjen që do t'u jepet teksteve zyrtare të një natyre legjislative administrative dhe legale dhe përkthimeve zyrtare të këtyre teksteve.

(5) Koleksionet e veprave artistike ose letrare, të tilla si enciklopedi dhe antologji, të cilat për arsye të përzgjedhjes ose të rregullimit të përmbajtjeve të tyre përbëjnë krijime intelektuale, do të mbrohen si të tilla pa paragjykuar të drejtën e autorit secilës prej veprave që përbën pjesë të koleksioneve të tilla.

(6) Veprat e përmendura në këtë nen do të gëzojnë mbrojtje në të gjitha vendet e Bashkimit. Kjo mbrojtje do të veprojë për përfitim të autorit dhe vazhduesit të tij në titull.

(7) Kushtëzuar nga dispozitat e nenit 7(4) të kësaj Konvente, do të jetë një çështje për legjislacionin e vendeve të Bashkimit që të përcaktojnë hapësirën e aplikimit të ligjeve të tyre për veprat e artit të aplikuar dhe modeleve dhe dizenjove industriale, si dhe të kushteve nën të cilat do të mbrohen këto vepra, dizenjo dhe modele. Veprat e mbrojtura në vendin e origjinës, thjesht si dizenjo dhe modele, do të gëzojnë në një vend tjetër të Bashkimit vetëm një mbrojtje të tillë speciale si ajo që gëzojnë në atë vend dizenjot dhe modelet; gjithsesi, nëse një mbrojtje e tillë speciale nuk u jepet në atë vend, këto vepra do të mbrohen si vepra artistike.

(6) Mbrojtja nën këtë Konventë nuk do të aplikohet për lajmet e ditës ose për fakte të ndryshme të cilat kanë karakterin e temave të zakonshme të informacionit gazetaresk.

Neni 2 i dytë

Kufizime të mundshme të mbrojtjes së veprave të caktuara; 1. Fjalime të caktuara; 2. Përdorime të caktuara leksionesh dhe adresimesh (fjalimesh); 3. E drejta për të koleksionuar vepra të tilla

(1) Do të jetë çështje e legjislacionit të vendeve të Bashkimit që të përjashtojnë tërësisht ose pjesërisht nga mbrojtja e dhënë në nenin paraardhës, fjalime politike dhe fjalime të mbajtura gjatë proceseve ligjore.

(2) Është gjithashtu një çështje për legjislacionin e vendeve të Bashkimit që të përcaktojnë kushtet nën të cilat leksionet, adresimet dhe veprat e tjera të së njëjtës natyrë, të cilat i janë përhapur publikut, mund të riprodhohen nga shtypi, radiotelevizioni, t'i komunikohen publikut me tel dhe të bëhen subjekt i komunikimit publik, siç shqyrtohet në nenin 11 të dytë (1) të kësaj Konvente, kur një përdorim i tillë justifikohet nga qëllime informacioni.

(3) Gjithsesi, autori do të gëzojë të drejtën ekskluzive të formimit të një koleksioni të veprave të tij të përmendura në paragrafin e mësipërm.

Neni 3

Kriteret e së drejtës për mbrojtje: 1. Shtetësia e autorit; vendi i publikimit të veprës; 2. rezidenca e autorit; 3. veprat e papublikuara; 4. veprat e publikuara në të njëjtën kohë

(1) Mbrojtja e kësaj Konvente do të aplikohet tek:

(a) autorët të cilët janë shtetas të një vendi të Bashkimit për veprat e tyre të publikuara ose jo;

(b) autorët që nuk janë shtetas të njërit prej vendeve të Bashkimit për veprat e tyre të publikuara fillimisht në njërin prej vendeve të Bashkimit ose në të njëjtën kohë në një vend jashtë Bashkimit dhe në një vend të Bashkimit.

(2) Autorët që nuk janë shtetas të njërit prej vendeve të Bashkimit, por që kanë rezidencën e tyre në një prej tyre do të konsiderohen si shtetas të atij vendi për qëllimet e kësaj Konvente.

(3) Shprehja "vepra të publikuara" do të thotë vepra të publikuara me konsensusin e autorit të tyre çfarëdo qoftë mjete i prodhimit të kopjeve, duke marrë parasysh se mundësimi i këtyre kopjeve ka qenë i tillë që të kënaqë kërkesat e arsyeshme të publikut duke marrë parasysh natyrën e punës. Shfaqjet e veprave dramatike, dramatiko-muzikore, kinematografike ose të veprave muzikore, recitimet publike të veprave letrare, komunikimi me kabëll ose radiotelevizion, i veprave artistike ose letrare, ekspozimi i veprës së artit dhe ndërtimi i një vepre ose arkitekture nuk do të përbëjnë publikim.

(4) Një vepër do të konsiderohet e publikuar njëkohësisht në disa vende, nëse ajo është publikuar në dy ose më shumë vende brenda 30 ditëve nga publikimi i saj i parë.

Neni 4

Kriteri i të drejtës për mbrojtjen e veprave kinematografike, veprat e disa punëve artistike dhe arkitekturore

Mbrojtja e kësaj Konvente do të zbatohet edhe nëse kushtet e nenit 3 nuk plotësohen tek:

(a) autorët e veprave kinematografike, prodhuesi i të cilave ka rezidencën kryesore ose atë të zakonshme në një nga vendet e Bashkimit;

(b) autorët e veprave arkitekturore të ngritura në një nga vendet e Bashkimit ose të veprave të tjera artistike të përmbledhura në ndërtesa ose struktura të tjera të vendosura në vendet e Bashkimit.

Neni 5

Të drejtat e garantuara; 1. dhe 2. Jashtë vendit të origjinës;

3. Në vendin e origjinës; 4. "vendi i origjinës"

(1) Autorët, përsa i përket veprave për të cilat ata mbrohen nga kjo Konventë, në vendet e Bashkimit, përveçse në vendin e origjinës, gëzojnë të drejtat që do t'i japin shtetasve, tani e tutje, ligjet e tyre respektive.

(2) Gëzimi dhe ushtrimi i këtyre të drejtave nuk do të kushtëzohet nga asnjë formalitet; gëzime dhe ushtrime të tilla janë të pavarura nga shtrirja e mbrojtjes, në vendin e origjinës së veprës. Si pasojë, përveç dispozitave të kësaj Konvente, shtrirja e mbrojtjes aq sa mbështetja e dhënë autorit për të mbrojtur të drejtën e tij, do të qeveriset ekskluzivisht nga ligjet e vendit në të cilin është bërë mbrojtja.

(3) Mbrojtja në vendin e origjinës drejtohet nga ligje të brendshme. Gjithsesi, kur autori nuk është shtetas i vendit të origjinës së veprës për të cilën ai është nën mbrojtjen e kësaj Konvente, do të gëzojë në atë vend të njëjtat të drejta si autorët vendas.

(4) Vendi i origjinës do të konsiderohet:

(a) vendi i Bashkimit ku është publikuar vepra për herë të parë;

në rastin e botimeve të njëkohëshme të veprave në disa vende të Bashkimit që japin kohëzgjatje të ndryshme, vendi me kohëzgjatje më të shkurtër.

(b) në rastin e veprave të botuara njëkohësisht në vendin jashtë Bashkimit dhe në vendin e Bashkimit - vendi i fundit;

(c) në rastin e veprave të pabotuara ose të veprave të botuara për herë të parë në një vend jashtë Bashkimit, pa publikim të njëkohshëm në vendin e Bashkimit, vendi i Bashkimit, shtetas i të cilit është autori, parashikon se:

(i) kur këto janë vepra kinematografike, bërësi i të cilave e ka selinë ose vendqëndrimin e zakonshëm në një nga vendet e Bashkimit, vendi i origjinës do të jetë ai vend, dhe

(ii) kur këto janë vepra arkitekturore të ngritura në një nga vendet e Bashkimit ose të veprave të tjera artistike të përmbledhura në një ndërtesë ose struktura të tëra të vendosura në një nga vendet e Bashkimit, vendi i origjinës do të jetë ai vend.

Neni 6

Kufizimet e mundshme të mbrojtjes së disa veprave të veçanta të shtetasve të disa vendeve jashtë Bashkimit: 1. Në vendin e publikimit fillestar dhe në vende të tjera;

2. Mos prapaveprimi; 3. Shënime

(1) Kur ndonjë vend jashtë Bashkimit nuk e mbron, në një mënyrë të përshtatshme për veprat e autorëve që janë shtetas të njërit prej vendeve të Bashkimit, Shteti i fundit mund të kufizojë mbrojtjen e dhënë veprave të autorëve që janë tashmë në datën e publikimit, shtetas të vendeve të tjera dhe nuk janë rezidentë të zakonshëm në një nga vendet e Bashkimit. Nëse vendi i publikimit të parë përfiton nga kjo e drejtë, vendeve të tjera të Bashkimit nuk do t'u kërkohej t'i japin veprave atë që kushtëzohet nga një trajtim i veçantë, një mbrojtje më të gjerë se ajo dhënë atyre në vendin e publikimit të parë.

(2) Asnjë kufizim i paraqitur sipas paragrafit të mësipërm nuk do të ndikojë në të drejtat të cilat një autor mund t'i ketë përfituar nga vepra të publikuara në një vend të Unionit para se këto kufizime të ishin në fuqi.

(3) Vendet e Bashkimit që kufizojnë mbrojtjen e të drejtës së autorit në përputhje me këtë nen do të njoftojnë Drejtorin e Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (që këtej e tutje të quajtur "Drejtori i Përgjithshëm") me një deklaratë të shkruar, duke specifikuar vendet për të cilat është kufizuar mbrojtja dhe kufizimet për të cilat të drejtat e autorëve, që janë shtetas të këtyre vendeve, janë kushtëzuar. Drejtori i Përgjithshëm do të komunikojë menjëherë këtë deklaratë të gjitha vendeve të Bashkimit.

Neni 6 i dytë

Të drejtat morale: 1. Për të deklaruar autorësinë; Të kundërshtosh disa modifikime dhe veprime të tjera mohuese (deroguese); 2. Pas vdekjes së autorit;

3. Kuptimi i shpërblimit

(1) Pavarësisht nga të drejtat ekonomike të autorit dhe pas transferimit të të drejtave të pashkruara, autorët kanë të drejtë të deklarojnë autorësinë e veprave të tyre dhe të tregojnë shtrembërimin, shkatërrimin ose modifikimet e tjera ose veprimet e tjera mohuese (deroguese) në lidhje me veprat e pashkruara të cilat paragjykohej për nderin ose reputacionin e tij.

(2) Të drejtat e garantuara të autorëve, pas vdekjes së tyre, në përputhje me paragrafin e mësipërm, do të mbahen të paktën deri në pushimin e të drejtave ekonomike dhe do të ushtrohen nga personat ose institucionet e autorizuara nga legjislacioni i vendit ku është deklaruar mbrojtja. Gjithsesi, ato vende legjislacioni i të cilave, në momentin e ratifikimit të tyre ose të pranimit në këtë Akt, nuk do të përfitojnë nga mbrojtja pas vdekjes së autorëve të gjitha të drejtat e parashikuara në paragrafin e mësipërm mund të parashikojnë që disa nga këto të drejta të mbarojnë së mbajturi pas vdekjes së tij.

(3) Kuptimi i shpërblimit për të ruajtur të drejtat e dhëna nga ky nen do të drejtohen (qeverisen) nga legjislacioni i vendit ku është deklaruar mbrojtja.

Neni 7

Kohëzgjatja e mbrojtjes: 1. Përgjithësim; 2. Për veprat kinematografike. 3. Për veprat anonime dhe veprat pseudonime; 4. Për veprat fotografike dhe veprat e artit të aplikuar; 5. Të dhënat fillestare të kompjuterizimit; 6. Afatgjatësia; 7. Afatshkurtësia;

8. Ligji i aplikuar, "krahasimi" i afatit (kohëzgjatja)

(1) Afati i mbrojtjes i dhënë nga kjo Konventë do të jetë jeta e autorit dhe 50 vjet pas vdekjes së tij.

(2) Megjithatë, në rastin e veprave kinematografike vendet e Bashkimit mund të parashikojnë që afati i mbrojtjes të mbarojë 50 vjet pasi vepra të jetë bërë e disponueshme për publikun me lejen e autorit ose duke rënë në ngjarje të tillë brenda 50 vjetëve nga bërja e një vepre të tillë, 50 vjet nga bërja.

(3) Në rastin e veprave anonime ose pseudonime, afati i mbrojtjes i njohur nga kjo Konventë do të mbarojë 50 vjet pas bërjes së veprës ligjërisht të disponueshme për publikun. Gjithsesi, kur një pseudonim i adaptuar nga autori nuk lë dyshime për identitetin e tij, afati i mbrojtjes do të jetë ai i parashikuar në paragrafin (1). Në qoftë se autori i një vepre anonime ose pseudonime zbulon identitetin e tij gjatë periudhës të më lartpërmendur, afati i mbrojtjes së zbatueshme do të jetë ai i parashikuar në paragrafin (1). Vendeve të Bashkimit nuk do t'u kërkohet të mbrojnë veprat anonime apo pseudonime kur është e arsyeshme të presupozohet që autori i tyre ka vdekur për 50 vjet.

(4) Do të jetë çështje e legjislacionit në vendet e Bashkimit të vendosin afatet e mbrojtjes së veprave fotografike dhe ato të veprave të artit të aplikuar aq sa ato janë të mbrojtura si vepra artistike; gjithsesi, ky afat do të zgjasë të paktën deri në fund të periudhës 25 - vjeçare nga bërja e veprave të tilla.

(5) Afati i mbrojtjes vazhdon me vdekjen e autorit dhe afati i parashikuar nga paragrafi (2), (3) dhe (4) do të fillojë nga dita e vdekjes ose e ngjarjes së referuar në këto paragrafë, por disa afate do të fillojnë gjithmonë në 1 janar të vitit që pason vdekjen apo ngjarje të tilla.

(6) Vendet e Bashkimit mund të japin një afat mbrojtjeje më të gjatë se ai i parashikuar në paragrafin e mësipërm.

(7) Ato vende të Bashkimit të lidhura me aktin e Romës së kësaj Konvente e cila u jep, në legjislacionin e tyre shtetëror në fuqi në kohën e nënshkrimit të këtij Akti, afat më të shkurtër mbrojtjeje se ajo e parashikuar në paragrafin e mësipërm do të ketë të drejtën të mbajnë afate të tilla kur të ratifikojnë apo pranojnë Aktin prezent.

(8) Në çdo rast, afati do të administrohet nga legjislacioni i vendit ku është deklaruar mbrojtja; megjithatë, deri sa legjislacioni i atij vendi të parashikojë ndryshe, nuk do të rritet afati i fiksuar në vendin e origjinës së veprës.

Neni 7 i dytë

[Afati i mbrojtjes së veprave të autorësisë tyë përbashkët]

Dispozitat e nenit paraardhës do të zbatohen edhe në rastin e veprave të autorësisë së përbashkët. Këtu parashikohet që afati i matur nga vdekja e autorit do të llogaritet nga vdekja e autorit të fundit të mbetur gjallë.

Neni 8

E drejta e përkthimit

Autorët e veprave letrare dhe artistike të mbrojtura nga kjo Konventë do të gëzojnë të drejtën ekskluzive të bërjes dhe të autorizimit të përkthimit të veprave të tyre nëpërmjet afateve të mbrojtjes të të drejtave të tyre në veprat origjinale.

Neni 9

E drejta e riprodhimit: 1. Përgjithësim; 2. Përrjashtime të mundshme;

3. Regjistrime figurash dhe tingujsh

(1) Autorët e veprave letrare dhe artistike të mbrojtur nga kjo Konventë do të kenë të drejtën ekskluzive të autorizojnë riprodhimin e këtyre veprave, në çdo mënyrë ose formë.

(2) Do të jetë çështje e legjislacionit të vendeve të Bashkimit të lejojnë riprodhimin e veprave të tilla në disa raste të veçanta, që parashikojnë se riprodhime të tilla nuk konfliktohen me shfrytëzimin normal të veprave dhe nuk paragjykojnë pa arsye interesat legjitime të autorëve.

(3) Çdo regjistrim tingulli apo figure do të konsiderohet si një riprodhim për qëllime të kësaj Konvente.

Neni 10

Disa përdorime të lira të veprave: 1. Kuotatimet; 2. Ilustrimet në mësimdhënie;

3. Tregimi i burimeve dhe autorëve

(1) Do të jetë e lejueshme të bëhen kuotatime nga veprat të cilat tashmë janë ligjërisht të disponueshme për publikun, kur parashikohet se bërja e tyre është në përputhje me praktika të ndershme dhe shtrirja e tyre nuk shtohet e justifikuar nga qëllimi, duke përfshirë kuotatimet nga artikujt në gazeta periodike në formë të përmbledhjeve të shtypura.

(2) Do të jetë çështje e legjislacionit në vendet e Bashkimit dhe e marrëveshjeve të veçanta të bëra mes tyre që do të lejojnë përdorimin e shtrirjes së justifikuar nga qëllimi i veprave letrare ose artistike, nga mënyra e ilustrimit në publikime, radiopërhapës ose regjistrime tingujsh apo pamjesh për mësimdhënie, në rat se një përdorim i tillë është i përshtatshëm me një praktikë të ndershme.

(3) Kur përdorimi është bërë nga punët në përputhje me paragrafin e mësipërm të këtij neni, përmendja do të bëhet nga burimi (fillimi) dhe në emër të autorit, nëse shfaqet aty.

Neni 10 i dytë

Përdorimi i mëtejshëm i përdorimit të lirë të mundshëm të veprave të disa artikujve dhe veprave radiopërhapëse; 2. Të veprave të para ose të dëgjuar në lidhje me ngjarje konkrete

(1) Do të jetë çështje e legjislacionit të vendeve të Bashkimit lejimi i riprodhimit nga shtypi, radiopërhapësi ose komunikimi me publikun me kabëll të artikujve të publikuar në gazeta ose periodikë për çështje aktuale politike, ekonomike, fetare dhe të veprave të radiopërhapura të të njëjtit karakter, në rastet në të cilat riprodhimi, radiopërhapja ose një komunikim i tillë muk është shprehimisht i rezervuar. Megjithatë, burimi duhet të jetë gjithmonë i treguar qartë. Pasojat legale të thyerjes së këtyre detyrimeve do të përkufizohen nga legjislacioni i vendit ku është deklaruar mbrojtja.

(2) Gjithashtu, do të jetë çështje e legjislacionit të vendeve të Bashkimit të përcaktojë kushtet nën të cilat, për qëllim të raportimit të ngjarjeve aktuale në kuptimin e fotografisë, kinematografisë, radiopërhapjes ose komunikimit me kabëll publikut, punët artistike apo letrare të para ose të dëgjura në kursin e ngjarjeve të lejuara, me shtrirje të justifikuar nga qëllimi i informimit, mund të riprodhohen dhe të bëhen të disponueshme për publikun.

Neni 11

Disa të drejta në vepra muzikore dhe dramatike; 1. E drejta e ekzekutimeve publike dhe e komunikimit publikut të ekzekutimeve; 2. Përsa i takon përkthimeve

(1) Autorët e veprave dramatike, dramatiko-muzikore dhe muzikore do të gëzojnë të drejtën ekskluzive për të autorizuar:

(i) ekzekutimin publik të veprave të tyre, duke përfshirë ekzekutime publike të tilla të çdo mënyre ose procesi;

(ii) çdo komunikim publikut të ekzekutimeve të veprave të tyre.

(2) Autorët e veprave dramatike, dramatiko-muzikore dhe muzikore do të gëzojnë gjatë kohës së plotë të të drejtave të tyre për veprat origjinale, të njëjtat të drejta që i takon për përkthimet e tyre.

Neni 11 i dytë

Të drejtat e radiopërhapjes dhe të tjera lidhur me to: 1. Radiopërhapja dhe komunikimet e tjera me kabëll, komunikimet publike të radiopërhapjes me kabëll ose riradiopërhapja, komunikimi publik i radiopërhapjes me zë ose instrumente analogë; 2. Licencat e detyrueshme; 3. Regjistrimet: regjistrimet afatshkurtra

(1) Autorët e veprave letrare dhe artistike do të gëzojnë të drejtën ekskluzive të autorizojnë:

(i) radiopërhapjen e veprave të tyre ose komunikimin e tyre publik me çdo metodë tjetër me kabëll përhapje të shenjave, tingujve ose imazheve;

(ii) çdo komunikim me kabëll publikut ose me radiopërhapje të radiopërhapjes së veprave, kur ky komunikim është bërë nga një organizatë, jo nga ajo origjinale;

(iii) komunikimi publikut me zë ose me mjet tjetër analog transmetimi, me shenja, tinguj ose imazhe, radiopërhapje e veprave.

(2) Do të jetë çështje e legjislacionit të vendeve të Bashkimit të vendosin kushtet nën të cilat të drejtat e përmendura në paragrafin paraardhës mund të ushtrohen, por këto kushte do të zbatohen vetëm në vendet ku ato janë paracaktuar. Ato nuk do të paragjykojnë, në asnjë rrethanë, të drejtat morale të autorit, as të drejtën e tij për të mbajtur shpërblim të drejtë i cili, në mungesë të marrëveshjes, do të fiksohet nga autoriteti kompetent.

(3) Në mungesë të ndonjë kushti (specifikimi) të kundërt, leja e dhënë në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni nuk do të nënkuptojë lejen e regjistrimeve nga përdorimi i instrumenteve regjistruara të tingujve apo të imazheve, radiopërhapja e veprave. Sidoqoftë, do të jetë çështje e legjislacionit të vendeve të Bashkimit të përcaktojnë rregullimin për regjistrime të shkurtëra të bëra nga organizata radiopërhapëse nga ndihma e lehtësirave të veta të përdorura për radiopërhapjen. Ruajtja e këtyre regjistrimeve në arkivat zyrtare, në bazë të karakterit të tyre dokumentar jo të zakonshëm, të autorizohen nga legjislacioni i tyre.

Neni 11 i tretë

Disa të drejta në veprat letrare; 1. E drejta e recitimit publik dhe e komunikimit publikut të recitimit; 2. Për përkthimet

(1) Autorët e veprave publike do të gëzojnë të drejtën ekskluzive të autorizimit:

(i) recitimi publik i veprave të tyre, duke përfshirë disa recitime publike të çdo lloji;

(ii) çdo komunikim publikut të recitimeve të veprave të tyre.

(2) Autorët e veprave letrare do të gëzojnë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së të drejtave të tyre në veprat origjinale, të njëjtat të drejta që kanë të bëjnë me përkthimet e tyre.

Neni 12

E drejta e përshtatjes, rregullimit dhe ndryshimeve të tjera

Autorët e veprave artistike dhe letrare gëzojnë të drejtën ekskluzive të autorizimit për përshtatje, rregullim dhe ndryshime të tjera të veprave të tyre.

Neni 13

Kufizime të mundshme të të drejtës së regjistrimit të punëve muzikore dhe të çdo pune lidhur me to: 1. Licencat e detyruara; 2. Masat tranzitore; 3. Konfiskimi i importimit të kopjeve pa lejen e autorit

(1) Çdo vend i Bashkimit mund t'i imponojë vetes rezervime dhe kushte mbi të drejtat ekskluzive të garantuara autorëve të veprave muzikore dhe të autorëve të çdo fjale, regjistrimet e të cilëve bashkë me disa fjalë muzikore janë tashmë të autorizuara nga i fundit, të autorizojnë regjistrimet e tingujve të asaj veprave muzikore bashkë me disa fjalë nëse ka; por të gjitha këto rezervime dhe kushte do të zbatohen vetëm në vendin i cili ka imponuar ato dhe nuk do të

1920

paragjykojnë në asnjë situatë të drejtat e atyre autorëve të përfitojnë shpërblime të njëjta të cilat, në mungesë të marrëveshjeve do të fiksohen nga autoriteti kompetent.

(2) Regjistrimet e veprave muzikore të bëra në një vend të Bashkimit, në përputhje me nenin 13 (3) të Konventës, nënshkruar në Romë në 2 qershor 1982 dhe në Bruksel në 26 qershor 1948, mund të riprodhohet në atë vend pa lejen e autorit të veprës muzikore, deri në datën 2 vjet pas bashkimit të atij vendi me anë të këtij Akti.

(3) Regjistrimet e bëra në përputhje me paragrafin e (1) dhe (2) të këtij neni dhe të importuara pa lejen nga palët përkatëse të vendit ku ata janë trajtuar si regjistrime të paligjshme do të jenë të lejueshme të konfiskohen.

Neni 14

Të drejtat kinematografike dhe shoqëruese; 1. Përshtatja dhe riprodhimi kinematografik; Shpërndarja; Ekzekutimi, interpretimi publik dhe komunikimi me fill i veprave si rezultat i përshtatjes ose riprodhimit; 2. Përshtatja e prodhimeve kinematografike;

3. Licencat jo të detyrueshme

1. Autorët e veprave artistike dhe letrare do të kenë të drejtën ekskluzive të autorizimit:

(i) përshtatja prodhimeve kinematografike dhe riprodhimi i këtyre punëve dhe shpërndarja e veprave të përshtatura ose të riprodhuara;

(ii) ekzekutimet, intepretimet publike dhe komunikimet me publikun me kabëll të veprave që rezultojnë të përshtatura dhe riprodhuara.

(2) Përshtatja në çdo mënyrë tjetër artistike e prodhimeve kinematografike që rrjedhin nga vepra artistike ose letrare, pa paragjykuar autorizimin e autorit të prodhimeve kinematografike, i nënshtrohen autorizimit të autorëve të veprave origjinale.

(4) Dispozitat e nenit 13(1) nuk do të aplikohen.

Neni 14 i dytë

Dispozita të veçanta që kanë të bëjnë me veprat kinematografike: 1. Asimilimi me veprën "origjinale"; 2. Pronësia, kufizimi i disa të drejtave të disa kontribuesve;

3. Disa kontribues të tjerë

(1) Një vepër kinematografike do të mbrohet si një vepër origjinale pa paragjykuar të drejtën e autorit në çdo vepër, e cila mund të jetë e përshtatur ose e riprodhuar. Pronari i të drejtës së autorit në një vepër kinematografike do të gëzojë të gjitha të drejtat si autori i një veprë origjinale, që përfshin të drejtat që refrohen në nenin e mësipërm.

(2) (a) Pronësia e të drejtës së autorit në një vepër kinematografike do të jetë çështje e legjislacionit të vendit ku është shpallur mbrojtja.

(b) Megjithatë, në vendet e Bashkimit, të cilat sipas legjislacionit përfshin midis pronarëve të të drejtave të autorit në një vepër kinematografike autorë të cilët kanë sjellë kontributet e tyre në bërjen e veprës, autorë të tillë, në qoftë se kanë ndërmarrë të kontribuojnë nuk duhet të kundërshtojnë dhe në mungesë të kushteve speciale, riprodhimin, shpërndarjen, shfaqet publike, komunikimin me publikun me kabëll, radiopërhapjen ose çfarëdo komunikimi me publikun ose nëntitullimin dhe dublimin e tekstit të veprës.

(c) Çështja nëse forma e ndërmarrjes që referohet më lart për aplikimin e paragrafit të mësipërm (b), duhet ose nuk duhet të jetë në një marrëveshje të shkruar ose në një akt të shkruar të të njëjtit efekt, është një çështje për legjislacionin e vendit ku krijuesi i veprës kinematografike ka rezidencën e tij të zakonshme ose kryesore. Megjithatë, është çështje e legjislacionit të vendit të Bashkimit, ku është shpallur mbrojtja, të përcaktojë nëse ndërmarrja e thënë më lart duhet të jetë në marrëveshje të shkruar ose në akt të shkruar me të njëjtin efekt. Vendet që do e përcaktojnë në legjislacionin e tyre do të njoftojnë Drejtorin e Përgjithshëm me një Deklaratë me shkrim, e cila do të komunikohet nga ai menjëherë në vendet e tjera të Bashkimit.

(d) Me "kusht special ose të kundërt" do kuptojmë kufizimin e kushtit që është përkatës me ndërmarrjen e lartpërmendur.

(3) Po të mos sigurohet nga legjislacioni kombëtar e kundërta, dispozitat e paragrafit (2) (b) më sipër nuk do të jenë të zbatueshme për autorët e skenarëve, dialogëve dhe veprave muzikore të krijuara për bërjen e veprës kinematografike dhe për Drejtorin e Përgjithshëm të tyre. Megjithatë, ato vende të Bashkimit, legjislacioni i të cilave nuk përmban ligje që sigurojnë zbatimin e paragrafit (2) (b) për një drejtues të tillë, do të njoftojnë Drejtorin e Përgjithshëm me anë të një deklarate të shkruar, e cila do të komunikohet menjëherë nga ai tek të gjitha vendet e Bashkimit.

Neni 15

E drejta e përforsimit të të drejtave të mbrojtura

Kur emri i autorit tregohet ose kur pseudonimi nuk lë dyshime si për identitetin e autorit; 2. Në rastin e punëve kinematografike; 3. Në rastin e punëve anonime ose pseudonime; 4. Në rastin e disa punëve të papublikuara dhe autorëve të panjohur

1. Në rastin kur autori i veprave artistike ose letrare, mbrojtur nga kjo Konventë, në mungesë të provave të kundërta, merret parasysh si e tillë dhe rrjedhimisht merr përsipër të kryejë procedura shkeljeje në shtetet e Bashkimit do të jetë e mjaftueshme për emrin e tij të shfaqej në punët e ndryshme si zakonisht. Ky paragraf do të jetë i aplikueshëm edhe nëse ky emër do të jetë një pseudonim kur ky i fundit nuk lë dyshime për identitetin e tij.

2. Personi apo korporata, emri i së cilës shfaqet në një punë kinematografike në mënyrë të zakonshme, në mungesë të provave të kundërta, pranohet si prodhuesi i punës së thënë.

3. Në rastin e veprave anonime dhe pseudonimeve të tjera nga ato të paraqitura në paragrafin e mësipërm (1), publikuesi emri i të cilit shfaqet në punë, në mungesë të provave të kundërta gjykohet të prezantohet autori dhe në këtë mënyrë atij do t'i jepet e drejta të mbrojtë dhe përforsojë të drejtat e autorit. Dispozitat e këtij paragrafi do të pushojnë së zbatuari kur autori shfaq identitetin dhe vendos kërkesën e tij të autorësisë për veprën.

4. (a) Në rastin e punëve të papublikuara, kur identiteti i autorit është i panjohur, por kur të gjitha gjasat thonë se ai është një pjesëtar i vendeve të Bashkimit, do të jetë një çështje për legjislacionin e këtij vendi të emërojë autoritetin kompetent, i cili do të prezantojë autorin dhe do t'i jepet e drejta të përforsojë të drejtat në vendet e Bashkimit.

(b) Vendet e Bashkimit, të cilat bëjnë emërime të tilla nën termat e kësaj klauzole, do të njoftohet Drejtori i Përgjithshëm, i cili, me anë të një deklarate me shkrim, do të japë informacion të plotë në lidhje me autoritetin e emëruar. Ai do ta komunikojë menjëherë këtë deklaratë tek të gjitha vendet e Bashkimit.

Neni 16

Shkelja e kopjeve: 1. Konfiskimi; 2. Konfiskim në importim; 3. Ligji i aplikueshëm

1. Cenimi i kopjes së një vepre do të dëmtohet me konfiskim në çdo vend të Bashkimit ku vepra gëzon mbrojtje me ligj.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm do të aplikohen edhe te riprodhimet që vijnë nga një vend ku puna nuk është e mbrojtur ose nuk ruhet më me ligj.

3. Konfiskimi do të kryhet në përputhje me legjislacionin e çdo vendi.

Neni 17

Mundësi kontrolli të qarkullimit, prezantimit apo ekspozimit të punës

Dispozitat e kësaj Konvente nuk mundën në asnjë mënyrë të ndikojnë të drejtën e qeverisë së çdo vendi të Bashkimit të lejojë, kontrollojë apo ndalojë, me legjislacion apo me rregullore, qarkullimin, prezantimin apo paraqitjen e një pune në lidhje me të cilin autoriteti kompetent mund të shohë të nevojshme t'a përdorë atë të drejtë.

Neni 18

Veprat ekzistuese në kohën e hyrjes në fuqi të Konventës: 1. Mundësia e mbrojtjes kur mbrojtja nuk ka mbaruar ende në vendin e origjinës; 2. Mundësia e mbrojtjes kur mbrojtja ka mbaruar në vendin ku është deklaruar; 3. Zbatimi i këtyre parimeve;

4. Raste të veçanta

(1) Kjo Konventë do të zbatohet në të gjitha veprat të cilat, në momentin e hyrjes në fuqi, nuk kanë rënë në dorën e publikut në vendin e origjinës nëpërmjet mbarimit të afatit të mbrojtjes.

(2) Sidoqoftë, nëse nëpërmjet mbarimit të afatit të mbrojtjes, e cila ishte dhënë më parë, një vepër ka rënë në dorën e publikut të vendit ku mbrojtja është shpallur, vepra mos të mbrohet sërish.

(3) Zbatimi i këtyre parimeve do të jetë subjekt i dispozitave të mëparshme në konventa të veçanta i efekteve ekzistuese ose për t'u përfshirë mes vendeve të Bashkimit. Në mungesë të dispozitave të tilla, vendet respektive do të vendosin, secila aq sa i takon, kushtet e zbatimit të këtyre parimeve.

(4) Dispozitat e mësipërme, gjithashtu, do aplikohen në rast të pranimeve të reja në Bashkim dhe në rastet në të cilat mbrojtja është e përhapur nga aplikimi i nenit 7 ose nga abandonimi i rezervimeve.

Neni 19

Mbrojtja më e madhe se rezulton në Konventë

Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të përjashtojnë bërjen e një deklarate për përfitimin e një mbrojtje më të madhe, e cila mund të fuqizohet nga legjislacioni i çdo vendi të Bashkimit.

Neni 20

Marrëveshje e veçantë mes vendeve të Bashkimit

Qeveritë e vendeve të Bashkimit ruajnë të drejtën të hyjnë në marrëveshje të veçanta mes tyre deri aty ku këto marrëveshje u garantojnë anëtarëve të tyre më shumë të drejta se ka dhënë Konventa ose mban dispozita të tjera jo në kundërshtim me Konventën. Dispozitat e marrëveshjeve ekzistuese të cilat kënaqin këto kushte mbeten të aplikueshme.

Neni 21

Dispozita të veçanta që u takojnë vendeve në zhvillim; 1. Referenca në shtojcë;

2. Pjesa shtojcë e Aktit

(1) Dispozita të veçanta përsa u përket vendeve në zhvillim janë përfshirë në shtojcë.

(2) Sipas dispozitave të nenit 28 (1) (b), shtojca formon një pjesë të këtij Akti.

SHTOJCË

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR SA I PËRKET VENDEVE NË ZHVILLIM

Neni 1

Mundësitë e hapura për vendet në zhvillim; 1. Disponueshmëria e disa mundësive; Deklarimet; 2. Zgjatja e efekteve të deklarimeve; 3. Fundi i statusit të vendeve në zhvillim; 4. Stojat ekzistuese të kopjeve; 5. Deklaratat që u përkasin disa territoreve;

6. Kufijtë e reciprocitetit

(1) Çdo vend i deklaruar si një vend në zhvillim konform praktikës së krijuar të Asamblesë së Përgjithshme të Shteteve të Bashkuara, të cilat ratifikojnë ose pranohen në këtë Akt, nga të cilat ky apendiks formon një pjesë thelbësore dhe e cila, duke i përkitur situatës ekonomike dhe nevojave kulturore dhe sociale, nuk e konsideron veten menjëherë në një pozicion të bëjë dispozita për

mbrojtjen të gjithë të drejtave siç parashikohen në këtë Akt, mundet nga një njoftim depozituar tek Drejtori i Përgjithshëm në kohën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose pranimit ose kushtëzuar nga neni V(1)(c), në çdo kohë, të deklarojë që mund të vihet në dispozicion të lehtësive të parashikuara në nenin II ose të lehtësive të parashikuara në nenin III, ose në të dy këto. Është e mundur që të bëjë një deklaratë në përputhje me nenin V(1)(a).

(2) (a) Çdo deklaratë nën paragrafin (1), njoftuar para mbarimit të periudhës prej 10 vjetësh nga hyrja në fuqi e nenit 1 deri 21 dhe këtij apendiksi në përputhje me nenin 28(2) do të ketë efekte deri në përfundim të periudhës që përmendëm. Çdo deklaratë e tillë mund të rinovohet e gjitha ose në një periudhë të pjeshme të 10 vjetëve secila me një njoftim depozituar te Drejtori i Përgjithshëm jo më shumë se 15 muaj dhe jo më pak se 3 muaj para mbarimit të periudhës 10- vjeçare të shpërndarjes.

(b) Çdo deklaratë nën paragrafin (1), njoftuar pas mbarimit të periudhës 10 vjet nga hyrja në fuqi e nenit 1-21 dhe kësaj shtojce në përputhje me nenin 28(2), do të jetë efektiv deri në mbarim të periudhës 10-vjeçare të shpërndarjes. Çdo deklaratë e tillë mund të rinovohet siç parashikohet në fjalinë e dytë të nënparagrafit (a).

(3) Çdo vend i Bashkimit, i cili ka mbaruar së qeni vend në zhvillim siç parashikohet në paragrafin (1), nuk do të lejohet më të rinovojë deklaratën e vet siç parashikohet në paragrafin (2) dhe patjetër do të revokojë deklaratën e vet, vende të tilla do të privohen nga përdorimi i mundësive, referuar në paragrafin (1) nga mbarimi i periudhës 10-vjeçare të shpërndarjes ose nga mbarimi i periudhës 3-vjeçare pasi të ketë mbaruar së konsideruari, si dhe në zhvillim, secila nga këto periudha mbaron më vonë.

(4) Kur, në kohën që deklarata e bërë nën paragrafin (1), (2) mbaron së qeni efektive, janë kopjet në stok, të cilat janë bërë nën licencën dhe në sajë të kësaj shtojce të tilla kopje mund të vazhdojnë të shpërndahen deri sa stoqet të mbarojnë.

(5) Çdo vend i cili lidhet nga dispozitat të këtij Akti e cila ka depozituar një deklaratë ose një njoftim në përputhje me nenin 31(1) në respekt të zbatimit të këtij Akti në një territor të caktuar, situata e të cilit është analoge me atë të vendeve referuar në paragrafin (1), mund në respekt të territoreve të tilla, të bëjë një deklaratë referuar paragrafit (1) dhe një njoftim të rinovuar referuar paragrafit (2). Për sa këto deklarata apo njoftime mbeten efektive, dispozitat e kësaj shtojce do të pranohen në territorin në lidhje me atë që është bërë.

(6) (a) Fakti që vendet vihen në dispozicion të çdo mundësie, siç referohet në paragrafin (1), nuk do të lejojë vendet e tjera të japin më pak mbrojtje sesa detyrohet të japë nën nenin 1-20.

(b) E drejta për të zbatuar trajtimin reciprok të parashikuar në nenin 30 (2) (b) fjalina e dytë, nuk do të, deri në datën në të cilën periudha e zbatueshme nën nenin 1 (3) mbaron, ushtrohet në lidhje me veprat, vendin e origjinës të së cilës është vendi i cili ka bërë një deklaratë në përputhje me nenin V(1) (a).

Neni II

Kufizimet e të drejtës së përkthimit; 1. Licencat e dhëna nga autoritetet kompetente; 2. Tek; 4. Kushtet që lejojnë dhënien e disa licencave; 5. Qëllimet për të cilat licencat mund të jepen; 6. Përfundimi i licencave; 7. Veprat të bëra kryesisht me ilustrime; 8. Veprat e dala jashtë qarkullimit; 9. Licencat për organizatat e radiopërhapjes

(1) Çdo vend që ka deklaruar se do vihet në dispozicion të mundësive të parashikuara në këtë nen do të autorizojë, për aq sa veprat e publikuara në formë të printuar ose analoge të riprodhimit të jenë të përfshira, për të zëvendësuar për të drejtën ekskluzive të riprodhimit të parashikuar në nenin 8 një sistem të licencave joekskluzive dhe jo të transferueshme, dhënë nga autoritetet kompetente nën kushtet vazhduese dhe kushtëzuar nga neni IV.

(2) (a) Kushtëzuar nga paragrafi (3), nëse pas mbarimit të periudhës prej 3 vjetësh ose të çdo periudhe të vendosur nga legjislacioni i vendit të pashkuar, duke filluar në datën e publikimit të parë të veprës, një përkthim i veprave të tilla nuk është publikuar në një gjuhë me përdorim të gjerë në atë vend nga pronari i të drejtës së përkthimit ose me autorizimin e tij, çdo shtetas i vendeve të tilla mund të marrë një licencë për të bërë një përkthim të veprave në gjuhën e thënë dhe të publikojnë përkthimin në formë të printuar ose analoge të riprodhimit.

(b) Licenca me kushtet e parashikuara nga ky nen mundet, gjithashtu, të jepet nëse të gjitha edicionet e përkthimit të publikuar në gjuhënn përkatese janë të papërdorshme.

(3) (a) Në rastin e përkthimit në një gjuhë e cila nuk është në përdorim të gjerë në një ose më shumë vende të zhvilluara të cilat janë anëtare të Bashkimit, një periudhë prej një viti do të zëvendësohet për një periudhë prej 3 vjetësh referuar paragrafit (2)(a).

(c) Çdo vend referuar paragrafit (1) mund, me një marrëveshje unanime të vendeve të zhvilluara që janë vende të Bashkimit dhe në të cilat e njëjta gjuhë është në përdorim të gjerë, zëvendëson, në rastin e përkthimit me atë gjuhë, për një periudhë prej 3 vjetësh referuar paragrafit (2)(a) një periudhë të shkurtër siç përcaktohet nga marrëveshje të tilla, por jo më pak se 1 një vit. Megjithatë, parashikimet e fjalive të mëparshme nuk do të zbatohen aty ku gjuha në tekst është anglisht, frëngjisht ose spanjisht. Drejtori i Përgjithshëm do të njoftohet për çdo marrëveshje të tillë nga Qeveritë të cilat e kanë bërë atë.

(4) (a) Asnjë licencë e marrë pas 3 vjetësh nuk do të jepet nën këtë nen derisa periudha e mëtejshme prej 6 muajsh të ketë pasuar dhe asnjë licencë e mbajtur pas një viti nuk do të jepet nën këtë nen derisa periudha pasardhëse prej 9 muajsh të ketë pasuar:

(i) nga data në të cilën aplikanti detyrohet, me kërkesën e përmendur në nenin IV(a) ose

(ii) ku identiteti ose adresa e pronarëve të së drejtës së përkthyesit është e panjohur nga data në të cilën aplikanti sjell, si parashikohet në nenin IV(2), kopje të aplikimit të tij drejtuar autoritetit kompetent për të dhënë licencën.

(b) Nëse, gjatë periudhës 6 ose 9 mujore, një përkthim në një gjuhë në lidhje me të cilën aplikimi i bërë është publikuar nga pronari i të drejtës së përkthimit ose me autorizimin e tij, asnjë licencë nën këtë nen nuk do të jepet.

(5) Çdo licencë nën këtë nen do të jepet vetëm për qëllim mësimdhënieje, studimi, kërkimi.

(6) Nëse një përkthim i një veprë është publikuar nga pronari i të drejtës së përkthimit ose me autorizimin e tij në një çmim të arsyeshëm, relativisht, me atë të vendit të vet për punë të krahasueshme, çdo licencë e dhënë nën këtë nen do të mbarojë, nëse një përkthim i tillë është në të njëjtën gjuhë dhe kryesisht me të njëjtin kontekst me përkthimin e publikuar nën licencë. Çdo kopje tashmë e bërë më parë mbarimit të licencës mund të vazhdojë të shpërndahet derisa stoku i tyre të mbarojë.

(7) Për veprat që janë ndërtuar kryesisht me ilustrime, një licencë për të bërë dhe publikuar një përkthim të një teksti dhe për të riprodhuar dhe publikuar ilustrimin mund të jepet vetëm nëse kushtet e nenit III janë tashmë të plotësuara.

(8) Asnjë licencë nuk do të jepet nën këtë nen kur autori ka nxjerrë nga qarkullimi të gjitha kopjet e veprave të tij.

(9) (a) Një licencë për të bërë një përkthim të veprës e cila është publikuar në formë të printuar ose analoge të riprodhimit mundet, gjithashtu, të jepet tek një organizatë radiopërhapëse duke patur një seli në vendin referuar HHN paragrafit (1), mbi një aplikim bërë organit kompetent të atij vendi nga organizata e thënë, parashikonte që të gjitha kushtet e mëtejshme të jenë takuar:

(i) përkthimi është bërë një kopje e bërë dhe e kërkuar në përputhje me ligjet e vendeve të pashkruara;

(ii) përkthimi është vetëm për përdorim në radioëpërhapës të destinuar ekskluzivisht për mësimdhënie ose për qarkullimin e rezultateve të kërkimeve teknike ose shkencore të specializuara nga ekspertë në profesione të veçanta;

(iii) përkthimi është përdorur ekskluzivisht për qëllimet e referuara në kushtet e paragrafit (2) nëpërmjet radiopërhapjes, bërë ligjërisht dhe të destinuara për marrësin në territorin e vendit të thënë, duke përfshirë radiohapjen, bërë nëpërmjet mjedisit të regjistrimeve zanore dhe vizuale ligjërisht dhe ekskluzivisht bërë për qëllime të radiopërhapjeve të tilla;

(iv) të gjitha përdorimet e përkthimeve janë pa ndonjë qëllim tregtar.

(b) Regjistrimet e tingujve ose të figurave të përkthimeve të cilat ishin bërë nga organizata të radiopërhapjes nën licencën e dhënë nga ky paragraf mund, për qëllimin dhe kushtëzuar nga kushtet referuar në paragrafin paraardhës (a) dhe me marrëveshjen e asaj organizate, gjithashtu, të përdoren nga një tjetër organizatë radiopërhapje, duke pasur selinë e vet në vendin organi kompetent i të cilit jepte licencën në pyetje.

(c) Parashikohet se të gjitha kushtet dhe kriteret, të parashtruara në paragrafin (a), janë takuar, një licencë mundet gjithashtu t'i jepet një organizate radiopërhapjeje për të përkthyer çdo tekst të përfshirë në një fiksion audio-vizual ku fiksioni i tillë ishte përgatitur vetë dhe publikuar për qëllimin e vetëm të të qenit i përdorur në lidhje me aktivitete sistematike edukimi.

(d) Kushtëzuar nga paragrafi (a) tek (c), dispozitat e paragrafëve më parë do të zbatohen në dhënien dhe ushtrimin të çdo licence të dhënë nën këtë paragraf.

Neni III

Kufizimet mbi të drejtat e riprodhimit: 1. Licencat e dhëna nga autoritetet kompetente; 2. Tek; 5. Kushtet që lejojnë dhënien e licencave të tilla; 6. Mbarimi i licencave;

7. Veprat të cilat ky nen zbatohet

(1) Çdo vend, i cili ka deklaruar që do të vihet në dispozicion të mundësive të parashikuara në këtë nen, do të lejojë të zëvendësojë për një të drejtë ekskluzive të riprodhimit të parashikuar në nenin 9 një sistem të licencave joekskluzive dhe jo të transferueshme, të dhëna nga autoriteti kompetent nën kushtet e mëtejshme dhe kushtëzuar nga neni IV.

(2) (a) Nëse, në lidhje me veprat të cilat do të zbatohet ky nen nga paragrafi (70), pas mbarimit të:

(i) periudhës specifike përkatëse në paragrafin (3), duke filluar në datën e publikimit të parë të një edicioni të veçantë të veprës, ose

(ii) çdo periudhë e gjatë e vendosur nga legjislacioni shtetëror i vendit që i referohet paragrafit (1), duke filluar, në të njëjtën datë, kopje të botimeve të tilla nuk janë shpërndarë në atë vend publikut të gjerë ose në lidhje me aktivitete sistematike edukimi nga pronari i të drejtës së botimit ose me autorizimin e tij, me një çmim të arsyeshëm relativisht me atë normal të vendit për vepra të krahasueshme, çdo shtetas i vendeve të tilla mund të mbajnë një licencë për të riprodhuar dhe publikuar botime të tilla ose çmimin më të ulët për të përdorur në lidhje me aktivitetet sistematike edukative.

(b) Një licencë për të riprodhuar dhe publikuar një botim, i cili është shpërndarë siç përshkruhet në paragrafin (a), mund, gjithashtu, të jepet nën kushtet e parashikuara në këtë nen nëse, pas mbarimit të periudhës të zbatueshme, asnjë kopje e autorizuar i atij edicioni nuk ka qenë në shitje për një periudhë prej 6 muajsh në vendin përkatës tek publiku i gjerë ose në lidhje me aktivitetet sistematike edukative me çmimin e arsyeshëm me atë normal të vendit për punë të krahasueshme.

(3) Periudha referuar paragrafit (2) (a) (I) do të jetë 5 vjet me përjashtim të:

(i) për veprat të shkencave natyrore dhe fizike, duke përfshirë matematikën dhe të teknologjisë, periudha do të jetë 3 vjet;

(ii) për veprat e fiksuara, poezi, drama dhe muzikë dhe për librat e artit periudha do të jetë 7 vjet.

(4) (a) Asnjë licencë e mbajtshme pas tre vjetësh nuk do të jepet nën këtë nen derisa të mos ketë mbaruar periudha prej 6 muajsh:

(i) nga data në të cilën aplikanti mbaron me kërkesat e përmendura në nenin IV(1), ose

(ii) ku identiteti apo adresa a pronarit të së drejtës së riprodhuesit është e panjohur nga data në të cilën aplikanti e dërgon, siç parashikohet në nenin IV(2), kopje të aplikimeve të tyre dërguar autoriteteve kompetente për të dhënë licenca.

(b) Aty ku licencat mund të mbahen pas periudhave të tjera dhe aty ku mund të aplikohet neni IV (2), asnjë nuk do të jepet pasi të ketë mbaruar periudha tre mujore nga data e shpërndarjes së kopjeve të aplikimit.

(c) Nëse, gjatë periudhës tre ose 6-mujore që i referohet paragrafi (a) dhe (b) më sipër, shpërndarja siç parashikohet në paragrafin (2) (a) ka marrë pjesë, asnjë licencë nuk do të jepet nën këtë nen.

(d) Asnjë licencë nuk do të jepet nëse autori ka përjashtuar nga qarkullimi të gjitha kopjet e botimit për riprodhimin dhe publikimin e të cilit licenca është aplikuar.

(5) Një licencë për të riprodhuar dhe publikuar një përkthim nuk do të jepet nën këtë nen në rastet e mëposhtme:

(i) aty ku përkthimi nuk është publikuar nga pronari i të drejtës së përkthimit ose me autorizimin e tij; ose

(ii) aty ku përkthimi nuk është në një gjuhë me përdorim të gjerë në vendin në të cilin është aplikuar.

(6) Nëse kopjet e një botimi të një vepre janë shpërndarë në vendin referuar paragrafit (1) te publiku i gjerë ose në lidhje me aktivitetet sistematike edukative nga pronari i të drejtës së riprodhimit ose, me autorizimin e tij, me një çmim të arsyeshëm krahasuar me atë të vendit për vepra të krahasueshme, çdo licencë e dhënë nën këtë nen do të mbarojë nëse ky botim është në të njëjtën dhe me të njëjtin kontekst në përmbajtje si botimi i ri është publikuar nën licencën e folur. Çdo kopje e bërë para mbarimit të licencës mund të vazhdojë të shpërndahet derisa stoku i tyre të mbarojë.

(7) (a) Kushtëzuar nga paragrafi (b), veprat për të cilat ky nen zbatohet do të kufizohet te veprat e publikuara në forma të printuara ose analoge të riprodhimit.

(b) Ky nen do të zbatohet, gjithashtu, për riprodhimet në formë audio-vizuale të fiksimeve audivizuale të bëra ligjërisht duke përfshirë çdo vepër të mbrojtur të trupëzuar aty dhe për përkthimet e çdo teksti të trupëzuar në një gjuhë me përdorim të gjerë në vendin në të cilin licenca është zbatuar, gjithmonë parashikon që fiksime audio-vizuale në fjalë ishin përgatitur dhe publikuar për qëllimin e vetëm të të qenit të përdorur në lidhje me aktivitete sistematike edukative.

Neni IV

Dispozitat e mblendhura të licencave nën nenin II dhe III: 1. Dhe 2. Procedura;

3. Tregimi i autorit dhe titulli i veprës; 4. Eksportimi i kopjeve; 5. Shënime;

6. Kompensimi

(1) Një licencë nën nenin II ose III mund të jepet vetëm nëse aplikanti, në përputhje me procedurën e vendit përkatës, krijon tjetër nga ajo që ai ka kërkuar dhe është refuzuar, autorizimin nga pronari i së drejtës të bëjë dhe publikojë përkthimin ose të riprodhojë dhe publikojë botimin, siç mund të jetë rasti ose kujdesit të duhur nga ana e tij, ai ishte i pazoti të gjente pronarin e së drejtës. Në të njëjtën kohë të bërjes së kërkesës, aplikanti do të informojë çdo qendër informacioni kombëtare ose ndërkombëtare referuar paragrafit (2).

(2) Nëse pronari i së drejtës nuk mund të gjendet, aplikanti për një licencë do të dërgojë me postë të regjistruar kopjet e aplikimit të tij të më postë të regjistruar, tek autoriteti kompetent për të dhënë licencën, tek publikuesi emri i të cilit shfaqet në vepër dhe tek çdo qendër informacioni kombëtare ose ndërkombëtare, e cila mund të jetë shënuar në një njoftim të atij efekti të depozituar te Drejtori i Përgjithshëm, nga Qeveria e vendit në të cilin publikuesi mendohet se ka vendin e tij kryesor të biznesit.

(3) Emri i autorit do të tregohet në të gjitha kopjet e përkthimit ose riprodhimit publikuar nën një licencë të dhënë nën nenin II dhe III. Titulli i veprës do të shfaqet në të gjitha këto kopje. Në rastin e përkthimit, titulli origjinal i veprës do të shfaqet në çdo rast në të gjitha kopjet e dhëna.

(4) (a) Asnjë licencë e dhënë nën nenin II ose III do të shtrihet në eksportin e kopjeve dhe çdo licencë e tillë do të jetë e vlefshme vetëm për publikimin e përkthimeve ose të riprodhimit, mund të jetë rasti në territorin e vendit për të cilin ato zbatohen.

(b) Për qëllimet e paragrafit (a), nocioni i eksportit do të përmbajë dërgimin e kopjeve nga çdo territor në vendin i cili, në lidhje me atë territor, ka bërë një deklaratë nën nenin 1 (5).

(c) Kur një ent qeveritar ose ent tjetër pulik i një vendi i cili ka dhënë një licencë për të bërë përkthimin nën nenin II në një gjuhë tjetër përveç anglisht, frëngjisht ose spanjisht, dërgon kopjet e përkthimeve nën një licencë të tillë të një vendi, tjetër, të tilla dërgesa të kopjeve, për qëllim të këtij paragrafi, nuk do të konsiderohen për të ndërtuar eksport nëse nuk do të takohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(i) marrësit janë individët që janë shtetas të vendit autoriteti kompetent i të cilit u ka dhënë licencë ose organizata të grumbullimeve të këtyre individëve;

(ii) kopjet të jenë bërë për t'u përdorur vetëm për qëllim të mësimdhënies, kërkimeve, studimeve;

(iii) dërgimi i kopjeve dhe më te shpërndarja e tyre te marrësit është pa ndonjë qëllim tregtar; dhe

(iv) vendi në të cilin janë dërguar kopjet ka rënë dakort me vendin autoriteti kompetent i të cilit ka dhënë licencën për të lejuar marrjen ose shpërndarjen ose të dyja dhe Drejtori i Përgjithshëm është vënë në dijeni të Marrëveshjes nga qeveria e vendit në të cilin është dhënë licenca.

(5) Të gjitha kopjet e publikuara nën një licencë të dhënë në sajë të nenit II dhe (III) mund të bëjnë një njoftim në një gjuhë të përshtatshme, duke theksuar që kopjet janë të disponueshme për shpërndarje vetëm në vendin ose territorin në të cilin licenca e thënë aplikohet.

(6) (a) Dispozita të përshtatshme duhet të bëhen në nivel kombëtar për të siguruar:

(i) që licenca siguron, në favor të pronarit të së drejtës së përkthimit ose të riprodhuesit, sipas rastit, për kompensimin që është konsistent me standardet e operimit normal të supremacisë në licencat lehtësisht të negociueshme mes personave në të dy vendet përkatëse; dhe

(ii) pagesa dhe transmetimi i kompensimeve do të ndërhyjë në rregullimin kombëtar të banknotave, autoriteti kompetent do të bëjë të gjitha përpjekjet, me anë të përdorimit të mekanizmave ndërkombëtarë të sigurojë transmetimin në banknotat e këmbyeshme ndërkombëtare ose të ekuivalentëve të tyre.

(b) Dispozita të përshtatshme duhet të bëhen nga legjislacioni vendeve për të siguruar një përkthim korrekt të veprave ose një riprodhim të saktë të botimeve të veçanta sipas rastit.

Neni V

Mundësia alternative për kufizimin e së drejtës së përkthimeve

1. Regjimi i parashikuar nën aktin e 1886 dhe 1896; 2. Pamundësia e ndryshimit të regjimit nën nenin II; 3. Koha limit për të zgjedhur mundësinë alternative

(1) (a) Çdo vend i ngarkuar për të bërë një deklaratë që do të verë në dispozicion veten të lehtësive të parashikuara në nenin II mund në vend, në kohën e ratifikimit ose pranimit në këtë akt:

(i) nëse ai është vendi në të cilin nenin 30(2) aplikohet, të bëjë një deklaratë nën atë dispozitë aq sa e drejta e përkthimit është kërkuar;

(ii) nëse ai është vendi në të cilin neni 30(2) (a) nuk aplikohet dhe, edhe nëse nuk është vendi jashtë Bashkimit, të bëjë një deklaratë siç parashikohet në nenin 30(2) (b) fjalia e parë.

(b) Në rastin e vendit i cili mbaron së përkrituri vendit në zhvillim, siç parashikohet në nenin 1(1), një deklaratë e bërë sipas këtij paragrafi do të jetë efektive deri në datën në të cilën periudha e aplikueshme nën nenin 1(3) mbaron.

(c) Çdo vend i cili ka bërë një deklaratë në përputhje me këtë paragraf nuk mund si pasojë të verë në dispozicion lehtësitë e parashikuara në nenin II edhe nëse ai përjashton deklaratën e pashkruar.

(2) Kushtëzuar nga paragrafi (3), çdo vend i cili ka vënë në dispozicion lehtësitë e parashikuara në nenin II nuk mund, si pasojë, të bëjë një deklaratë në përputhje me paragrafin (1).

(3) Çdo vend i cili ka mbaruar së qeni vend në zhvillim, siç parashikohet në nenin 1(1), nuk mund, më vonë se 2 vjet para mbarimit të periudhës së zbtueshme nën nenin 1(3), të bëjë një deklaratë për efektet e parashikuara në nenin 30(2)(b) fjalia e parë, megjithë faktin që ai nuk është një vend jashtë Bashkimit. Të tilla deklarime do të kenë efekt në datën në të cilën periudha e zbatueshme nën nenin 1(3) mbaron.

Neni VI

Mundësitë e aplikimit ose pranimit të aplikimeve të disa dispozitave të shtojcës përpara bërjes së lidhjes nga ai: 1. Deklarata; 2. Depozitimi dhe data efektive e deklaratës

(1) Çdo vend i Bashkimit mund të deklarojë, që nga data e këtij Akti dhe në çdo kohë përpara lidhjes nga neni 1 tek 21 dhe kësaj shtojce:

(i) nëse është një vend i cili është lidhur nga neni 1 tek 21 dhe kjo shtojcë do të ngarkohet të

vërë në dispozicion veten për lehtësitë siç referohet në nenin 1(1) që ai do të aplikojë dispozitat e nenit II ose të nenit III ose të të dy veprave, vendi i origjinës së të cilit është vendi i cili, në përputhje me paragrafin (ii) më lart, pranon aplikimin e atyre neneve të veprave të tilla ose i cili është lidhur nga neni 1 tek 21 dhe ky apendiks; deklarata të tilla mund, në vend të referimeve në nenin II, të referohen në nenin V;

(ii) që pranon aplikimet e kësaj shtojce për veprat të cilat është vendi i origjinës nga vendet të cilat kanë bërë një deklaratë nën paragrafin (I) më sipër ose një njoftim nën nenin 1.

(2) Çdo deklaratë e bërë nën paragrafin (1) do të jetë e shkruar dhe do të depozitohet pranë Drejtorit të Përgjithshëm. Deklarata do të jetë efektive nga data e depozitimit.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 31.12.2001
Doli nga shtypi më 31.12.2001

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë